



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 459/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prizren, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dega në Prizren.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.11.2013, nga subjekti politik LDK dega në Prizren, në të cilën theksohet se me datën 03.11.2013, në ora 9:00, në ditën zgjedhjeve Aziz Hodaj kandidat për këshilltar i LDK në Prizren ka kërcenuar dhe shantazuar për rrahje dhe veprime të tjera fizike qytetarin Faton Çoqaj nga fshati Gjonaj i Hasit në qendrën zgjedhore nr.200-15/a dhe atë për shkak të mos ndryshimit të bindjes së tij politike për ta votuar LDK-në.

### Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 të LZP-së, parashihet se “ Mund të apelohe vendimet e PZAP-it sikurse PZAP-i, mund ti rishikoj cilindo nga vendimet marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”.

Nga dëshmit e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t'i bënim të besueshëm pretendimet ankimore të ankuesit të PDK ndaj subjektit politik LDK-së. Mirpo pretendimet ankimore të kësaj natyre janë të pabazuara, pasi që dëshmitë e ofruara nuk janë të përgjithshme dhe të paqarta për të cilat nuk mund të vërtetohen.

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullorës së PZAP-i lidhur me ankesën e lartpërmendur u vendos si në diapozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 459/2013 më datën 07.11.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Hasan Shala**



***Këshillë Juridik:***

Ndaj këtij vendimi mund të paraitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda njëzetekatër (24)orë nga moment i marrjes së këtij vendimi nga PZAP-i.